



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.1030/2017**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gillogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, Hashim Deshishku nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**REFUZOHET** si i pabazuar apeli i parashtruar nga Hashim Deshishku kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me shenjën ZL.Anr.1030/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Hashim Deshishku, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, me të cilën ka pretenduar se ka mospërputhje të votave pasi që në fshatin Vranidoll në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ i kanë dalur 14 vota por sipas nënshkrimeve që i ka marr nga votuesit pretendon se i ka 20 vota. Poashtu parashtruesi i apelit pretendon se në fshatin Barilev në rezultatin përfundimtar nuk i figuron asnjë votë kurse nga nënshkrimet e votuesve të tij pretendon se i ka 44 vota si dhe nga informacionet e disa votuesve pretendon se i ka marrë 70 deri 80 vota. Në mbështetje të pretendimeve të tij apelit ia ka bashkangjitur deklaratat e disa votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pabazuar.**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se parashtruesi i apelit nuk ka identifikuar Qendrat e Votimit me të cilën pretendon shkeljet e parashtruara në apel. Prandaj, apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.1030/2017 më datën 12.11.2017.

**Kryesuesi i Panelit**  
**Zyheri Haziri**



### ***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*